

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist me Arsim të Mesëm, Sektori Tirana-Veri, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit (Kategoria IV-c).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Vendimit Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2022”; Urdhër Nr.6667/1, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist me Arsim të Mesëm ka për detyrë si më poshtë:

- Specialisti me Arsim të Mesëm varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
- Merr pjesë në inspektim sipas grupeve të punës ndarë me urdhër të brendshëm sipas njësive të miratuara nga Kryeinspektori.
- Trajton ankesat e marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizik dhe juridik.

Dokumentat që aplikanti për Specialist me Arsim të Mesëm duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);
5. Raport mjeko – ligjor;
6. Dëshmi penaliteti;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 30.09.2022 **ora: 14.00**